

SOME PARALLELISME OF THE CANON ELEMENTS IN THE NOVELS “BROKEN APRIL” AND “BLOOD SNAKES”

DISA PARALELIZMA TË ELEMENTEVE KANUNORE NË ROMANET “PRILLI I THYER” DHE “GJARPINJTË E GJAKUT”

Fatjona ABDULLAHI¹

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: fatjona.abdullahi@unite.edu.mk*

Abstract

This paper will discuss certain aspects of Albanian life where blood feuds have manifested in a more pervasive manner. Otherwise, the shedding blood is unavoidable phenomenon in all 11 books of the Kanun of Lekë Dukagjini, which is not the only existing Kanun, but it is the only one that has institutionalized blood feuds. We will briefly compare passages from Ismail Kadare's novel "Broken April" and Adem Demaçi's "The Snakes of Blood," two of the most representative works on blood feuds and the Kanun codes of the Albanians. This comparison aims to illustrate the articles or provisions that the Kanun clearly defines, which the authors bring to life and make more tangible through their application.

Keywords: Kanun, blood feuds, literature, novels.

Elementet kanunore të bartura në roman

E kaluara e popullit shqiptar mbetet histori e lavdishme e një populli i cili është përballur dhe i ka mbijetuar çdo stuhie duke e ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditat brez pas brezi deri në ditët e sotme. E gjithë kjo e kaluar e lavdishme e cila herë-herë tingëllon thujse mitike, nuk i ka shpëtuar edhe ruajtjes dhe trashëgimisë së disa dokeve dhe zakoneve të përlyera me gjakun e brezave të tërë ndër shekuj. Qëndresa shumëshekullore e shqiptarëve, arti dhe kultura e kultivuar në mjediset idilike e pastorale, shpirti dhe fryma e guximshme e një populli me rrënjë të thella në lashtësi, për më shumë se pesëqind vjet mbajti një strukturë administrimi e cila qëndronte si hierarki e paprekshme edhe atëherë kur shqiptarët pushtoheshin dhe u jepej mundësia “ta dënonin veten me ligjet e veta”. Për ta mbajtur një rregull dhe organizim jetësor, bëheshin pakte normash të cilat sa më të hershme që të ishin, aq më shumë predisponoheshin për t’u kthyer në kulte.

Këto sisteme të dala nga vetë populli, jo rrallë bashkëpërkonin me qëllimet ogurzeza të pushtuesve, sidomos të osmanëve të cilët kurrë nuk e morën mundimin të ndërhyjnë në këtë sistem rregullash siç ndërhyjnë dhe bënin represion në çdo sistem tjetër, arsimor, fetar e sidomos kulturor. Kanuni ishte një rregullator i jetës së shqiptarëve dhe sot e kësaj dite vazhdon të njihet, madje edhe të jetë aktual më së shumti për dukuri famëkeqe si gjakmarrja. Ky fenomen i vëllavrasjes është i lashtë sa vetë njeriu dhe në rastin e shqiptarëve ishte edhe i kodifikuar dhe i organizuar edhe juridikisht.

Mu për këtë, ky punim do të prekë disa nga segmentet e jetës së popullit shqiptar ku gjakmarrja shfaqet në mënyrë më invazive sepse përndryshe, derdhja e gjakut dhe marrja e gjakut janë dukuri e pashmangshme në të 11-të librat në të cilët është i ndarë Kanuni i Lekë Dukagjinit i cili nuk është i vetmi kanun ekzistues, por është i vetmi që e ka institucionalizuar gjakmarrjen. Ne do të bëjmë shkurtimisht përjasjen e disa pasazheve të romanit të Ismail Kadaresë “Prilli i thyer” dhe “Gjarpërinjtë e gjakut” nga Adem Demaçi, si dy nga veprat më përfaqësuese të gjakmarrjes dhe kodeve kanunore të shqiptarëve, për të ilustruar edhe nenet apo dispozitat që Kanuni i ka mirë të përcaktuara, por që autorët i sjellin më të gjalla dhe më të prekshme në zbatimin e tyre.

Në romanin *Gjarpërinjtë e gjakut*, është dhënë drama e dy familjeve kosovare, të Sejdi Goxhufit dhe Emin Malokut, të cilët për arsyen e mosdhënies së besës për vajzën që e kërkonin nuse nga familja Maloku, bien në gjak. Me fjalë të tjera, Goxhufët “ua marrin nderën” Malokëve duke mos ua dhënë të bijën për djalin e tyre dhe duke lidhur krushqi me Abaz Gjukën nami i të cilit ishte i madh për trimëri në ato vise të Kosovës. Në roman jepen shumë të gjalla skenat kur personazhet përjetojnë frikën e mosrënies në gjak, sepse bëhet fjalë për dy familje të cilat nuk ishin ende në gjak, në dallim nga pjesa më e madhe e asaj treve. Por, po aq të gjalla janë edhe skenat kur frika nga zhburrërimi, nga marrja e nderit, nga leçitja publike, e tejkalojnë çdo kufi sakrificë që mendja e njeriut në rrethana të zakonshme do të kishte drojë që ta shkelte.

Ndryshe nga Gjorgu - protagonist i romanit *Prilli i thyer*, i cili vihet përpara një akti gjysmë të kryer – një gjakmarrje e vjetër mbi 70 vjet e mbi 44 viktima, i riu kosovar, Mustafa Goxhufi nuk e pranon derdhjen e gjakut si dogmë, shkelja e së cilës merrej për herezi. Ai madje disa herë tenton ta bindë të atin për të kërkuar pajtimin me Emin Malokun: “*Dy duer janë për këta dy gishta ftyrë, po a nuk asht ma faqe e zezë me i ra pushkë vllaut tan?!... A nuk asht ma mirë qi tanë shqyptaria m’u ba nja, me t’ja kallë pushkën Turkut e me na i dhanë “Katër kalemata”, a me u ba na hamull nër veti?...*” (Demaçi 1990:74)

Por, megjithatë, nuk ia del ta bindë dhe epilogu nuk ndryshon as në familjen kosovare. Ndonëse në rastin Gjorgut, të cilin Kadareja na e sjell më pak të pranishëm në dualizmin shpirtëror që përjeton gjatë muajit akoma të palënë përgjysmë si një 26-vjeçar të cilit i binte mbi supë të lante gjakun e vëllai të vdekur përpara një viti e gjysmë, ose do t’i jepej kafeja nën gjunjë, Mustafai ishte i riu që të detyrohej të ishte në krye të një gjaknisjeje të re, por nuk i druhej leçitjes e të mos qenit burrë pse nuk derdhi gjak. Por, me gjithë përpjekjet për të dalë nga skenari i frikshëm i shuarjes së familjeve, as ai nuk ia del.

Atij i vihet në dijeni se ky ishte destinacioni i shqiptarëve nga i ati Sejdi Goxhufi derisa ia ritregon legjendën e gjarpërinjve të gjakut. Para qindra vitesh “*ishin kanë çue Shqyptari, Turku edhe Raja e kishin marrë udhën me shkue e me vetë se qysh jau ka çkrue zoti me e kapërcye dyjallakun...*” (Demaçi 1990:80) Derisa kishin mbërritur pas 7 konaqeve në shpellën e një plaku parashikues fati ditën e nesërme kur ishin zgjuar kishin parë gjarpërinj të cilët, ndryshe nga të tjerëve që ua patën rrethuar këmbën dhe ballin, shqiptarit gjarpri i kuq ia kishte mbështjellë dorën dhe i kishte ngulur thimthin te gishti tregues.

Plaku kishte bërë parashikimin e tij: “*Turkut i kish pa thanë: “Ty t’ka thithmue gjarpni i sefasë! Ti kie me ba sefa sa t’jenë jeta. Ty ta ka çkrue Perenia veç me nejtë kamëkryq e me sunue!” Rajës i kish pa thanë: “Ty t’ka thithmue gjarpni i vimit. Ti kie me punue e me vye sa t’jenë jeta! Ty ta ka çkrue Perenia me u çue me knojsit e parë e me ra ma i mramti i t’tanve!”*”

Shqiptarit i kish pa thanë: “ Ty t’ka thithmue gjarpni i gjakut. Ti kie me e vra vllaun tan e vllau yt ka me t’vra ty e s’kanë me t’u da gjaqet sa t’jenë jeta! Ty ta ka çkrue Perenia gjak me pi e gjak me vjellë!...” (Demaçi 1990:81). Rrëfenja e mësipërme që përdor babai plak si argument për pamundësinë e mosderdhjes së gjakut, rrjedhimisht tregon se shqiptarët vriteshin pa e ditur se për çfarë vriteshin.

Në këndvështrimin sociologjik apo edhe psikologjik, një popull gjaknxehtë i cili nuk sheh se çfarë i del përpara në momentin që i cenohet një koncept sociologjik më se fluid siç është nderi, do të poziciononte shqiptarët në kategorinë sanguine që nuk arrijnë të veprojnë racionalisht. Por, çështja është përtej një reagimi emocional, sidomos për faktin se gjakmarrja në jo pak raste, rikthehej dekada pasi që gjakrat ishin ulur, në kuptimin e asaj se, të dëmtuarit nuk ishin të nxehtë si në periudhën para besës 24-orëshe. Pas vrasjes, gjakësi kërkonte besën e vogël e cila ishte njëditëshe dhe më pas katundi e kërkonte atë të madhen, 30-ditëshe.

Një skenë të tillë e kemi me Gjorg Berishajn i cili pas vrasjes së Zef Kryeqyqes dilte lirshëm sepse *“ ishte i mbrojtur nga besa njëzetekatërorësh e më mire se nga çdo frëngji kulle apo kështjelle. Tytt e pushkëve të tyre çoheshin drejt mbi xhokt e zeza, por tani për tani ato s’kishin të drejtë të shtinin mbi të. Nesër, pasnesër... ndoshta. Kurse, po të kërkonte katundi besën tridhjetëditëshe për të, atëherë do të kishte edhe katër javë jetë të qetë. Pastaj...”* (Kadare 2015: 189) Pra, besa ishte siguria më e madhe që mund t’i jepej secilit, madje edhe gjakësit.

Por ekzistonte mundësia që kjo besë edhe të mos jepej nga familja e të vrrarit dhe në atë rast Kanuni e parashihet: *“ Po ngurroi shpija e të vramit e s’u gjegj me i dhânë bese katundit, dorërasit me gjithë shpijarë e kushrîni te dame zjarmit do të rrijë mshilë.”* (Gjeçovi 1993: 142) Ndërkaq, në rast se besa jepej, përsëri gjakësi ose familjarët e gjakësit ishte mirë që ta shmangnin familjen e të vrrarit dhe kurrsesi të mos provonin të krenoheshin, sepse besa mund të këputej me kërkesën e vetë fshatit: *Po pat besë shpija e dorërasit, të rrijn me mend e me nierzi në pûnë të vet, të ruhen si burrnimi si edhë granija e mos t’i shkaktojn dâme as trazime, per në kioshin ngiatas me shpi të të vramit e mos të shesin kreni. Po u prû keqas shpija e dorërasit ndaj Shpin e të vramit, katundi bashkë 79 me dorzânë t’a qortojë e, n’e lypët nevoia, të ndeshkohet me giobë e t’u kputet besa.* (Gjeçovi 1993: 143).

Diçka tjetër që është karakteristike, në besën e vogël, është se përpara se të jepet kjo besë, në gjaknxehtësi e sipër, mund të vriten edhe kushërinjtë e largët të gjakësit, ose siç Kanuni i quan *“ të damët e zjarmit”*: *Kushrinija e dâme me zjarm prej dorërasit mbrenda 24 orve të vrasës do të ruhen, sepsë, po i vrau shpija e të vramit, e mërr gjakun e vet. §.872. Po pshtuen pà u vrà mbas 24 orësh, do të dorzaniten me shpi të të vramit e do të jenë të lirë në punë të vet. §.873. Po vran kend prej kushrinis së dâme shpija e të vramit mbasi të kalojn 24 orët, ajo nuk mërr gjak, por bjen në giak.* (Gjeçovi 1993:143).

Pra, siç mund të shihet, ndryshe nga ç’e parashihte dikur Kanuni, se *Shpija e të, vramit nuk mujte me ndjekë as me vrà tjetërkend prej vllazensh, nipash a kushrijsh të gjaksorit, pos gishtit - dorërasit* (Gjeçovi 1993:143) ndërhyrjet e nevojshme ishin bërë, vetëm e vetëm që gjaku të mos pushonte së derdhuri, ose siç do ta përshkruante Kadareja, derisa të vriteshin njerëzit me pushkën e vet dhe dorën e tjetrit. Gjithashtu, legjendat dhe besëtytënitë mbi bazën e të cilave përligjej gjaku, si në rastin e tragjedisë së familjeve Maloku e Goxhufi, janë indikator i një vetëdijeje primitive dhe lehtësisht të manipulueshme.

Përfundim

Në fund, pasi kemi dhënë disa nga segmentet ku shfaqet gjakmarrja në jetën shoqërore të shqiptarëve, e ndërlydhur me dallime gjinore, me kultin e mikut e të besës dhe me nderin vetjak e të shoqërisë, nuk do të ishte e tepërt pyetja se çfarë vlere kishte Kanuni i Lekë Dukagjinit në kohën që zbatoheshin përkrah kanuneve të tjera simotra dhe përveç vlerës juridike, cila mund të ishte vlere që do t’i mveshnim këtij kanuni në ditët e sotme?

Ekzistojnë disa teori, sidomos referuar institucionit të gjakmarrjes të cilin kanuni e ka kodifikuar shprehimisht. Njohja e dispozitave që e rregullojnë gjakmarrjen, shpesh është menduar se, ka parandaluar derdhjen e gjakut nga frika e sanksionimit dhe mosndryshimit në kodin kanunor. Nga ana tjetër, mosnjohja me gjenezën e fenomenit të gjakmarrjes e vë në pikëpyetje vërtetësinë e këtij qëllimi të pretenduar, për parandalim dhe mbrojtje nga derdhja e gjakut.

Natyra thjesht irracionale e frymës kolektive të shqiptarëve, po ashtu nuk mund të merret për bazë si indicie e gjakmarrjes, nisur nga fakti se ekzistonin familje të cilat ishin në gjak afërsisht një shekull, kur çdo mllef dhe zemërim mund të ishte shuar dhe kur brezat që ishin në gjak as nuk e mbanin në mend shkakun e hyrjes në gjak me familjen tjetër.

Referencat

- [1]. Annan, Gabriele (1988), *Roughing It*, The New York Review of Book 35: 20 (22 December).
- [2]. Çabej, Eqrem (1977), *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë.
- [3]. Demaçi, Adem (1990), *Gjarpinjtë e gjakut*, Buzuku, Prizren.
- [4]. Demiraj, Shaban (1988), *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.
- [5]. Elsie, Robert (1997), *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë.
- [6]. Hysa, Mahmud (1996), *Shtjellime letrare*, Tetovë.
- [7]. Drini, Sulejman. Goçi, Ibrahim. Halimi, Mehmet. Gashi, Skender (1982), *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [8]. Gjeçovi, Shtjefën (1993), *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Albinform, Tiranë.
- [9]. Kadare, Ismail (2015), *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë.
- [10]. Qosja, Rexhep (1984), *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë.
- [11]. Scriven, George P. (1918), *Recent Observations in Albania*, The National Geographic Magazine 34, 1: 90-114.